

ECU SACCO

Per una raccolta del SECCO più ECO e più EQUA

PËRSE E BËN

ËSHTE një projekt eksperimental që lind me objektivin që të pakësoje sasinë e mbeturinave të “thata” dhe të vendosi një taksë më të barabartë/drejtë, për të bërë këtë qytetari duhet të jetë më shumë i vetëdijshëm dhe pjesëmarës.

Eksperimenti ka të bëjë me mbledhjen e materialit të THATË: përveç furnizimit të parë me qese EKOLOGJIKE, (e përshtatshme për nevojat familjare dhe mbi të cilën llogaritet taksa “TARI”), përdoruesi paguan nëse përdor më shumë qese nga ato që ka marrë. Projekti po përfshim një numër gjithmonë dhe më të madh të Komunave “CEM Ambiente” me rezultate ekologjike të vlerësueshme.

Bëhesh një qytetar më shumë i virtytshëm dhe i vetëdijshëm

Paguan në bazë të sasisë të mbeturinës “të thatë” që prodhon.

Më pak mbeturinë të Thatë prodhon dhe më shumë mbron ambientin dhe vendin ku jeton.

Përmirëson përqindjen e mbledhjeve të diferencuara të Komunës tënde

Rrit risurset ekonomike për komunitetin tënd, falë kursimit të aritur duke diferencuar më shumë.

KËSHILLAT PËR NJË PRAKTIKË TË MIRË

Zvogëlo sa më shumë që të mundesh volumin e mbeturinave të tua në mënyrë që të mbushësh mirë qesen ekologjike.

Bëj shpenzimet duke menduar se sa mbeturina do të prodhosh

Rrespekto territorin në të cilin jeton. Mos flak mbeturinat në koshte publikë, në buzë të rrugës ose në vendet e gjelbëruara.

Mendo gjithmonë për atë që po flak: verifiko nëse mund t’a hedhësh në një nga mbledhjet e diferencuara.



Per informazioni e segnalazioni

800.342.266

info e segnalazioni online:

www.cemambiente.it

ECU SACCO

Per una raccolta del SECCO più ECO e più EQUA

SI KU DHE KUR

Çfarë është qesja EKologjike?

Qesja EKologjike është qesja e re **gjysëmtraspjerrte** dhe e **gjurmueshme** për t'u përdorur **detyruesisht** për mbledhjen e mbeturinave të thata

Çfarë duhet të vendos në qesen EKologjike?

Mbeturinat "e thata" (Listën e gjen mbrapa kalendarit "CEM AMBIENTE" të Komunës tënde). Kujtohu të vendosësh në qesen EKologjike mbeturinat e lira pa i mbyllur në qese të tjera

Ku shpërndahet qesja EKologjike?

Në pikat e shpërndarjes në ditët dhe oraret e treguara mbrapa kalendarit "CEM AMBIENTE" në Komunën tënde.

Tërheqia qeseve EKologjike është e domosdoshme

Për sa qese EKologjike kam të drejtë?

Numri i qeseve që të takon varet nga përbërja e familjes tënde

ÇFARË më duhet për të tërhequr qesen EKologjike?

Për tërheqien e qeseve duhet të shkosh në pikat të shpërndarjes me kartën tënde "CRS" Karta Rajonale e Shërbimeve ose "CNS" Karta Shtetërore e shërbimeve ose "CEMcard"

Nëse më duhen qese të tjera EKologjike, ku mund t'i ble dhe sa kushtojnë?

Mund t'i blësh tek Zyra Ekologjike e Komunës tënde, duke përdorur tesserën "CRS" ose "CNS" ose "CEMcard" tënde me koston prej:

- 10 € për një rotull me 15 qese EKologjike prej 40 litrash

- 30 € për një rotull me 15 qese EKologjike prej 120 litrash

Çmimi përfshin koston e flakjes së mbeturinës që përmban qesja.

Pagesa e qese-ve do të ndodhë sipas mënyrave të vendosura nga Komuna jote.

Raste të veçanta:

Familje me fëmijë që nuk kanë mbushur 3 vjeç: në furnizim është i parashikuar një integrim i mëtejshëm i qeseve.

Persona me probleme të mospërmbajtjes: drejtoheni në Komunë për Tërheqien e qeseve me një vetëdeklarim.

Mund të përdor qese të tjera për mbeturinat e thata?

Jo, do të tërhiqen vetëm qeset EKologjike.

Si mund të përdor qeset gri/të tejdukshme të tepruara?

Mund të përdoren për të hedhur "Multipak".

Përse mbi qesen EKologjike është i stampuar një kod?

Sepse në rast nevojë, është e mundur të arrihet tek pronari i asaj EKOqese-je.

Përse disa qese EKologjike janë të kuqe dhe të tjera blu?

Qeset EKologjike të **KUQE** janë për përdoruesit shtëpiakë

Qeset EKologjike **BLU** janë për përdoruesit joshtëpiakë (ndërmarrje, dyqane, restorante, kafene etj.)

Dyshime të tjera?

Telefono në numrin jeshil të "CEM Ambiente" 800.342.266

Per informazioni e segnalazioni

800.342.266

info e segnalazioni online:

www.cemambiente.it



MBLEDHJE SHTËPIAKE



I THATË- Fraksioni i thatë

ÇFARË: artikuj kozmetikë dhe për higijenën personale si brisqe prej plastike, krëhër, furça, furçë dhëmbësh, pastrues veshi me pambuk, sapun, pelena dhe piceta higjienike (intime), manikota; objekte e tuba prej gome, dorashka kuzhine; artikuj si vizore, goma, mbetje lapsi, çngjyruar, stilolapsa dhe bojtuha, cd/dvd, letër karboni; pajisje për personin si rrip, geta, flokë, këpucë, pëlhurë; pajisje për shtëpinë si qirin, qese të fshesës elektrike, lecka të pista, materialin me jashtë shqitjet e qënëve dhe maceve, radiografi; objekte nga kuzhina si kapsula kafeje që nuk janë të biodegradueshme, lugë e pirunj prej plastike, bazament për prerjen prej plastike ose teflon, sfungjer, pllakeza insekticide, llastikë; gjithçka që nuk mund të ndahet përsëri.

SI: mbledhje në qese gjysëmtraspasente me një peshë jo më shumë se 20 kg.

KUR: nxjerrja brenda orës 06:00 të ditës së mbledhjes.

MOS të vendosen amballazhime (qelq, kanaçe, letër/karton, amballazhime prej plastike etj.)

MOS të përdoren qese të zeza ose qese të shpenzimeve.



«MULTIPAK» – amballazhime prej plastike, metali dhe me përbërës të ndryshëm

ÇFARË: amballazhime plastike: shishe dhe flakone prej plastike për ujin mineral, pijesh, vaj ushqimor, lëng frutash, qumësht; mbajtëse vezësh, rrjeta për fruta dhe perime, plastmas për ushqime, vazo të ndryshme, kontenjerë të tetrapak, vaska në shumë deti, enë të etiketuara “pe-pet-pvc-pp”, pjata dhe gota prej plastike (pa mbetje ushqimore), amballazh “blister” (me “filuska”); amballazhime prej alumini ose çeliku, kanaçe për pije, bombël për: parfume, llak dhe krem kuzhine; kuti të vogla për peshkun, tuba për krem, kapakë për kos, qese në alumin, tapa plastike dhe silikon, varëse rrobash prej plastike dhe prej metali etj.

KUR: nxjerrja brenda orës 06:00 të ditës së mbledhjes.

SI: mbledhje në qese gjysëm-traspasente.

MOS të vendosen materiale të ndryshme nga ato të treguara, letër dhe karton, mbajtëse për bojëra dhe tretës (të etiketuar “t/f”), shumë deti dhe telefon në sasi dhe dimensione të mëdha.



I LAGËSHT- Fraksioni i lagësht

ÇFARË: gjithçka që ka avancuar nga ushqimi i përpunuar dhe i gatuar, ushqime të skaduar, lëkurë frutash, funde të kafe-së dhe filtra çaji, lëvozhgë veze, lule dhe bimë të prera në sasi minimale, tapa, shkopinj prej druri të akulloreve.

SI: mbledhje në qese ose me kazan me rrota. Të përdoren vetëm qese të biodegradueshme.

KUR: nxjerrja brenda orës 06:00 të ditës së mbledhjes.

MOS i futni mbeturinat që nuk janë të biodegradueshme. (pelena, qese plastike, letër alumini, amballazhime në plastikë etj.) – MOS përdorni qese plastike.



LETËR- letër dhe karton

ÇFARË: gazeta, revista, broshurë publicitare, fletë dhe fletore, qese prej letre për bukë dhe fruta, libra, kartona të vegjël, kartona për pica (pa mbetje ushqimore), peceta prej letre, amballazhime të vogla prej kartoni të reduktuara në volum, pjesë amballazhimi në kartona të vegjël ose kartona normalë.

KUR: nxjerrja brenda orës 06:00 të ditës së mbledhjes.

SI: mbledhje në qese prej letre, kuti prej kartoni, pako të lidhura me një peshë jo më shumë se 20 kg. Ose kazanë (nëse janë të furnizuara nga Komuna).

MOS të futen brenda letër me yndyrë ose e pistë, mos të përdoren qese prej plastike.



QELQ- amballazhime prej qelqi

ÇFARË: shishe prej qelqi si të bardha edhe me ngjyrë (edhe me tapë), kavanoza prej qelqi (edhe me tapa ose me kapak). Shishe dhe kavanozat duhet të boshatisen komplet prej asaj që përmbajnë, mos të boshatiset vaji në lavaman.

KUR: nxjerrja brenda orës 06:00 të ditës së mbledhjes.

SI: mbledhja në kova ose në kazanë mbi rrota.

MOS vendos qese ose çanta prej plastike, objekte prej qeramike, porcelan ose qeramike (filxhan, pjata, vazo), llamba me neon, lamba, gota ose objekte prej kristali.

MBLEDHJE TË TJERA SHTËPIAKE



JESHILE– mbeturina bimore

ÇFARË: bar i prerë dhe gjethe, degë të holla.

KUR: nxjerrja brenda orës 06:00 të ditës së mbledhjes.

SI: mbledhje në kosha me një peshë jo më shumë se 20 kg ose kazanë me rrota.

Ky shërbim është aktiv në Komunitat e:

Agrate Brianza

Brugherio

Cambiagio

Carpiano

Cassina De' Pecchi

Cernusco Sul Naviglio

Cerro al Lambro

Colturano

Dresano

Gessate

Gorgonzola

Inzago

Lesmo

Rodano

Truccazzano

Vignate

Villasanta

Vimodrone (të prenotohet në Komunë)

Vizzolo Predabissi

MOS të vendosen degë me përmasa të mëdha .



MBLEDHJE TË MATERIALEVE TË RËNDA NË SHTËPI

Shërbim i rezervuar për përdoruesit shtëpiakë

Shërbimi i tërheqies në shtëpi (në buzë të rrugës) të mbeturinave të rënda është aktiv me prenotim në numrin jeshil “CEM AMBIENTE” 800.342.266

Ky shërbim është aktiv në Komunitat e:

Carpiano

Cassano d'Adda

Cernusco sul Naviglio

Colturano

Concorezzo

Gorgonzola

Lesmo

Liscate

Melzo

Pessano con Bornago

Trezzo sull'Adda

Villasanta

Vimodrone

Shërbim i rezervuar për përdoruesit shtëpiakë

ÇUARJA E MBETURINAVE NË PLATFORMËN EKOLOGJIKE

MËNYRA E HYRJES për njësitë shtëpiake:

Në Platformën Ekologjike mund të hyjnë **njësitë shtëpiake** për çarjen e mbeturinave urbane që kanë prejardhjen nga ndërtesat dhe vëndet të përdorura për banesë shtëpiake dhe ndodhen në teritorin komunal.

Hyrja në platformë mund të jetë e rregulluar nëpërmjet një sistemi të informatizuar dhe përdorimit të “CRS”-së (Karta Rajonale e Shërbimeve) ose “CNS”-së (Karta Nacionale e Shërbimeve).

LISTA E MATERIALEVE TË ALOKUESHME (QË MUND TË ÇOHEN):

a) **DRURI:** mallrat e qëndrueshme si mobiljet, dyer dhe dritare; paketime të tilla si mbajtëse druri dhe arka ose pjesë të imballazhit. Mobiljet duhet të jenë të ndara nga elementët me materiale të ndryshme (pasqyra, xham, metal, plastik) përpara hedhjes në kosh. Mobiljet që kanë shumë volum duhet të çmontohen dhe t’u zvogëlohet volumi.

b) **HEKURAT DHE SKRAPET METALIKE:** rrjeta për krevatin, kangjella metalike, objekti për nderjen e robave, tenxhere, rafte metalike, biçikleta.

Mos hidhni motoçikleta, filtra të vajit për lubrifikim, mbeturinat nga përpunimi i metaleve si pjesë të mbetura dhe pluhur, ambalazhime metalike të ndotura nga substanca të rrezikshme.

Mos hidhni aparate elektrike dhe elektronike.

c) **LETËR DHE KARTON:** gazeta, revista, fletë publicitare, fletë dhe fletore, qese letre për bukë dhe fruta, libra, kartona të vegjël, kartonat e picave (pa mbeturina ushqimore), piceta letre, ambalazhime kartoni të vogla me volum të reduktuar, pjesë ambalazhimi me karton të vogël ose karton.

Mos hidhni produkte me letër të “ciftëzuar” (për shëmbull: tapiceri, letër të plastifikuar), letër të pistë ose të lyer me lyër.

d) **XHAM DHE PLLAKA XHAMI:** faqe xhami, pasqyra, akuariume, qypa vere, gota kristali dhe objekte të tjera prej kristali.

Përpara hedhjes në kosh hiqni pjesët me material të ndryshëm (korniza, profile, kashtën e qypave të verës, zbukurime dhe pajisjet elektrike të akuariumeve).

e) **XHAM DHE AMBALLAZHIME:** shishe xhami si të bardha dhe me ngjyrë (edhe me tapë), vazo prej xhami (edhe me tapë ose kapak). Para se t’i hidhni në kosh zbrazini plotësisht shishet dhe vazot nga përmbajtja e tyre.

f) **PLASTIKA TË FORTA:** kasa, enë plastike, kova, vazo, tuba, orendi kopshti, lojëra.

Mos hidhni “Multipak” i cili mbledhet ekskluzivisht “derë më derë”.

g) **RRËNOJAT DHE MBETJET INERTE:** materjalet që kanë prejardhje nga shëmbje të vogla, vazo prej cimentoje ose prej balte, pjata, filxhane ose enë të tjera prej qeramike, balte ose porcelane, gurë, lavamanë dhe sanitarë prej qeramike.

Është e lejueshme hedhja në sasi modeste e mbetjeve të krijuara nga ndërhyrje të volga ndërtimi të bëra drejtpërdrejtë nga personi në banesën e tij me një sasi prej 0,5 m³ për dy hedhje në vit.

Nuk janë të pranueshme artefakte në cemento-amiant (Eternit), “kartonxhes”, lesh xhami, këllëf prej bitiumi.

h) **MBETURINA TË KOPSHTIT:** rrënjë, bar, gjethe, bime të kopshtit ose zbukurimi.

Mos fusni në kosh-in e fruta-ve dhe perime-ve të prishura të cilat hidhen me njësinë e lagësht të mbledhur “derë më derë”, gurë, degë dhe trungje pemësh.

i) **MBETURINA TË MËDHA:** dysheqe, kolltuqe, divane, moket, linoleum etj. Kjo mbledhje i përket të gjitha materialeve të pa riciklueshme dhe që nuk i takojnë mbledhjeve të tjera të diferencuara që aktualizohet në Platformën Ekologjike.

j) **RAEE – R1 - FRIGORIFER, NGRIRËS, KONDICIONER**

k) **RAEE – R2 LAVATRICE, THARËSE ROBASH, LARËSE DHE THARËSE, LARËSE PJATASH, MIKROONDE, PLLAKA TË PJEKJES, FURRA ELEKTRIKE, FURRA ME GAS**

l) **RAEE – R3 - TELEVIZOR DHE MONITOR**

m) **RAEE – R4 - PAJISJE TË VOGLA ELEKTROSHTËPIAKE DHE ELEKTRONIKE PËR KONSUM:**

fshesë me korent, makinë qepëse, hekur për hekurosje, makinë për të skuqur, frulator, kompjuter (njësi qëndore, mi dhe tastjerë), stampante, fax, telefon celular, telefon, videoregjistrator, radio, majtofon, enë elektrike, lojra elektrike dhe elektronike etj.

n) **RAEE – R5 - BURIME DRITE** llamba me neon ose me gazra të tjerë ose avull, llamba për kursim të energjisë.

o) **R.U.P. - BATERI DHE BATERI TË KONSUMUARA:** bateri një përdorimshe, të rikarikueshme, me kopse, bateri jo prej plumbi.

p) **R.U.P. - MBLEDHËS PREJ PLUMBI:** bateri për makina, motorra, aparate kundër vjedhjes etj.

q) **R.U.P. - VAJRA MINERALE:** vajra minerale dhe sintetike të përdorura për lubrifikimin e motorrëve ose pjesë të tjera mekanike të makinës, motorit ose makineri të tjera

r) **R.U.P. - BOJRA DHE PRODUKTE KIMIKE SHTËPIAKE:** bojra, ngjitës, izolues, bojë të holluara, hidro pikturë, acide, holluese, ngjitësa, herbicide, anti parazitare, heqës njollash etj. Duke përfshirë edhe mbajtësit e tyre mbi të cilat duhet të jetë e shkruajtur lloji i produktit që përmban për të lejuar shkatërrimin korrekt të tyre. Mbajtësit duhet të jenë të mbyllur hermetikisht për të evituar daljen e produktit. Përrjashtohen bombolat spray

s) **R.U.P. - BOMBOLA SPRAY ME ETIKETË “T” ose “F”:** bombola me produkte kimike, plot dhe bosh, të etiketuara me simbolet: Toksiske ose Merr Flake.

t) **R.U.P. - TONER FISHEKE:** për stampues lazer dhe me bojë.

u) **R.U.P. - ILACE TË SKADUARA OSE TË PA PËRDORURA:** hidhe ilacin me mbajtësin e tij (flakon, tubet ose mbajtësen me flluska)

v) **R.U.P. - VAJRA DHE YNDYRË VEGJETALE DHE SHTAZORE:** që kanë prejardhje nga pjekja dhe nga konservimi i ushqimeve.

MËNYRA E HYRJES PËR NJËSITE JO SHTËPIAKE:

Njësite jo shtëpiake që ndodhen në teritorin e komunës mund të përdorin platformën ekologjike vetëm për hedhjen e mbeturinave të ngjashme me ato urbane të prodhuara në teritorin e komunës ose për hedhjen e RAEE që e kanë prejardhien nga tërheqja 1:1 (një me një) e 1:0 (një me zero).

Hedhja e mbeturinave të ngjashme me ato urbane varet nga nënshkrimi i një akordi të veçantë me

“CEM Ambiente”, nga shkrimi në “Regjistrin Nacional të Menaxhuesve të Ambjentit” në kategorinë 2 bis – transportim të mbeturinave jo të rrezikshme për vetveten. Në rast të hedhjeve më të mëdha se 30 kg për një lloj mbeturine, hedhja duhet shoqëruar edhe me Formularin e Identifikimit të Mbeturinës.

Hedhja e mbeturinave elektrike dhe/ose elektronike (R.A.E.E.), është e varur nga nënshkrimi i një akordi të posaçëm me “CEM Ambiente”, nga shkrimi në “Regjistrin Nacional të Menaxhuesve të Ambjentit” në kategorinë 3 bis. Formulari për identifikimin e mbetjeve është i zëvendësuar nga plotësimi i Shtojcës II – Dokument i thjeshtëzuar për transportimin e mbetjeve me aparatura elektrike dhe elektronike.

Informacionet për hedhjen e mbeturinave nga njësite jo shtëpiake janë të disponueshme

- NË FAQEN INTERNET **WWW.CEMAMBIENTE.IT**
- NË SHPJEGUESIN QË GJENDET PRANË PLATFORMËS EKOLOGJIKE
- DUKE TELEFONUAR NË NUMRIN JESHIL (pa pagesë) 800.342.266